



VLERËSIMI I VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE TË VETTINGUT PËR GJYQTARËT DHE PROKURORËT NË KËNDVËSHTRIMIN E NDJEKJES PENALE

Analiza “Vlerësimi i vendimeve të institucioneve të vettingut për gjyqtarët dhe prokurorët në këndvështrimin e ndjekjes penale” u përgatit nga ekspertët e Qendrës ALTRI.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Qendrës A.L.T.R.I dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë e mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjera pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:
Qendra ALTRI
Email: qendra.altri@gmail.com



ANALIZË

Vlerësimi i vendimeve të institucioneve të vettingut për gjyqtarët dhe prokurorët në këndvështrimin e ndjekjes penale

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME	5
QËLLIMI DHE METODOLOGJIA	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
GJETJET KRYESORE	9
I. ANALIZË E KUADRIT LIGJOR MBI SHKARKIMIN DHE NDJEKJEN PENALE TË SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR PËR ÇËSHTJET PASURORE	11
II. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË PAVARUAR TË KUALIFIKIMIT NË RIVLERËSIMIN KALIMTAR DHE NDJEKJEN PENALE TË SHKELJEVE TË KONSTATUARA	16
III. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË PAVARUR TË APELIMIT NË RIVLERËSIMIN KALIMTAR DHE NDJEKJEN PENALE TË SHKELJEVE TË KONSTATUARA	18
IV. VEPRIMTARIA E KOMISIONERIT PUBLIK NË RIVLERËSIMIN KALIMTAR DHE NDJEKJEN PENALE TË SHKELJEVE TË KONSTATUARA	20
V. VEPRIMTARIA E STRUKTURËS SË POSAÇME PËR KRIMIN E ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIN (SPAK) PËR HETIMIN E SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR	21
VI. VEPRIMTARIA E GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË DHE APELIT KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT PËR GJYKIMIN DHE DËNIMIN E SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR	23
VII. VEPRIMTARIA E PROKURORIVE DHE GJYKATAVE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR HETIMIN DHE GJYKIMIN E SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR	25
VIII. ANALIZA E VENDIMEVE TË SHKARKIMIT TË SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR PËR ÇËSHTJE PASURORE	27
REKOMANDIME	36

SHKURTIME

GJK	Gjykata Kushtetuese
GJKKO	Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
GJL	Gjykata e Lartë
IKP	Institucioni i Komisionerëve Publikë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë Prokurorisë
KPA	Komisioni i Pavarur i Apelit
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KSH	Kuvendi i Shqipërisë
ONM	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Në vijim të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (“*vetting-ut*”) është konstatuar se megjithëse gjyqtarë dhe prokurorë janë shkarkuar nga detyra për deklarime të pamjaftueshme apo të parregullta pasurore, vetëm disa prej tyre janë referuar për hetime të mëtejshme penale në organin e akuzës. Ekziston ende një paqartësi ligjore dhe institucionale në praktikën e hasura gjatë procedurave të “*vetting-ut*”, lidhur me unifikimin e trajtimit të çështjeve që përmbajnë elemente të figurave penale për deklarimet e parregullta të pasurisë.

Kjo analizë ka për qëllim të marrë në shqyrtim dhe të evidentojë në mënyrë të detajuar përmbajtjen e vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, veçanërisht për shkarkimin nga detyra të subjekteve të rivlerësimit për çështje pasurore. Këto vendime kanë synimin të analizohen për ecurinë e ndjekjes së tyre të mëtejshme procedurale në zbatim të legjislacionit penal, duke nxjerrë në pah problematikat e ndeshura në këtë kuadër.

Qëllim tjetër është të analizohen dhe të nxirren përfundime mbi mosveprimet institucionale për të referuar për ndjekje penale të gjitha praktikën që kanë patur ngjashmëri në elementet e penalizimit pasuror për subjektet e rivlerësimit kalimtar.

Nëpërmjet kësaj analize, përfundimeve, gjetjeve dhe rekomandimeve të saj, synohet që të përftohet një evidentim i problematikave dhe një nxitje për të përmirësuar veprimtarinë dhe bashkëpunimin e organeve të rivlerësimit me strukturat e posaçme hetimore dhe gjyqësore. Dokumenti ka gjithashtu për qëllim të identifikojë edhe boshllëqe të karakterit ligjor, të cilat kanë ndikuar në apatinë institucionale për të denoncuar, hetuar dhe dënuar subjektet e shkarkuara që kanë konsumuar vepra penale në lëmin e deklarimit pasuror.

Analiza u hartua duke ndjekur një metodologji të qartë cilësore dhe sasiore të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, duke u bazuar në vendimet dhe informacionet zyrtare të organeve të “vettingut” dhe atyre të drejtësisë, si dhe në të dhënat e mbledhura nga studimet dhe intervistat me përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarëve investigativë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Reforma në drejtësi ishte një nga qëllimet kryesore kombëtare që synonte krahas të tjerash, përmirësimin e standardeve të integritetit në dhënien e drejtësisë, duke luftuar me mjete efikase korrupsionin në organet e hetimit dhe ato gjyqësore të të gjitha niveleve dhe juridiksioneve. Lufta ndaj këtij fenomeni lidhet me nevojën e çrrënjësjes së kulturës së pandëshkueshmërisë në sistemin e drejtësisë, i cili ishte një nga elementet kyç në dokumentin e miratuar nga Komisioni Ad Hoc Parlamentar i krijuar për reformën në drejtësi, ku përshkruhej në mënyrë të detajuar situata në këtë sistem dhe nevojat kryesore për ndërhyrje ligjore dhe institucionale¹.

Raportet vjetore të Komisionit Evropian², Departamentit të Shtetit Amerikan³ dhe shoqërisë civile, e shikojnë të lidhur ngushtë komponentin e zbatimit të ligjit me nivelin e luftës kundër korrupsionit dhe ndëshkueshmërisë së zyrtarëve publik. Në këtë kuadër, reforma në drejtësi dhe procesi i rivlerësimit kalimtar për gjyqtarët dhe prokurorët, ka si qëllim jo vetëm largimin e tyre nga sistemi si masë administrative, por edhe ndëshkimin e disa prej tyre si masë penale, kryesisht për çështjet pasurore.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), që nga fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (8 shkurt 2018) deri në mars 2022 ka marrë gjithsej 519 vendime⁴, ndër të cilat 191 vendime shkarkimi nga detyra kanë qenë për 119 gjyqtarë dhe 72 prokurorë. Nga vendimet e mësipërme, 163 prej tyre janë shkarkime, të cilat në dispozitiv përmbajnë shkaqe ligjore për çështje pasurore.

Ndërkohë që, nga të dhënat e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) rezulton se që nga fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (mars 2018 deri maj 2022) janë marrë gjithsej 131 vendime për juridiksionin e rivlerësimit kalimtar⁵, ndër të cilat 91 vendime kanë qenë për lënien në fuqi të vendimeve të KPK për shkarkim nga detyra të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga 91 vendime, rezulton se 82 vendime kanë qenë për çështje të karakterit të pasuror në deklarime.

¹ Miratuar me vendimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nr.14, dt.30.07.2015 "Për miratimin e Dokumentit Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip.pdf

² https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

³ <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/albania>

⁴ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2022/05/RAPORTI-STATISTIKOR-SHKURT-2018-PRILL-2022.pdf> (fq 1)

⁵ Të dhëna të marra nga faqja zyrtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, <https://kpa.al/juridiksion-rivleresimi-vendime/>

Komponenti pasuror, krahas atyre të integritetit dhe profesionalizmit, ka qenë një nga elementet kryesore që i është nënshtruar kontrollit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në dallim nga dy komponentët e tjerë, shkarkimi nga detyra për burime të dyshimta apo qëllimisht të parregullta pasurore ngre dyshime të arsyeshme që ndaj subjektit të rivlerësimit të vijohet më tej me ndjekjen penale të tij.

Referuar shifrave të mësipërme të KPK dhe KPA, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit për çështje pasurore. Nga të dhënat e mbledhura nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO), si dhe të rakorduar me ato të KPK dhe KPA, rezulton se nga çështjet për shkarkim pasuror të formës së prerë, vetëm 4 prej tyre janë referuar për ndjekje penale nga organet e rivlerësimit, përkatësisht vetëm nga KPK.

Ndjekja penale dhe dënimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shkarkuar nga procesi "*Vetting-ut*" duhet të konsiderohet një rrjedhojë e natyrshme e nevojës ligjore dhe institucionale për të çuar deri në fund luftën kundër pandëshkueshmërisë. Kjo dikton edhe dhënien e mesazheve të qarta për vendosmëri në parandalimin e shkeljeve të trupës së magjistratëve në detyrë. Kjo procedurë do të rriste gjithashtu, edhe besimin e publikut tek organet e drejtësisë, pasi vetëpastrimi dhe përgjegjshmëria e lartë brenda radhëve të magjistratëve, do të krijojë një tjetër imazh mbi integritetin e figurës së tyre dhe të sundimit të ligjit në tërësi.

Nevoja e qartësimit të rolit të KPK dhe KPA për referimin e veprave penale, si dhe unifikimit të praktikave të tyre për rastet e ndjekjes së mëtejshme penale ndaj subjekteve të rivlerësimit të shkarkuar nga detyra, është një detyrë që kërkon nga ana tjetër gatishmërinë e strukturave të posaçme hetimore për të vijuar më tej këtë proces deri në vendimmarrjen përfundimtare nga gjykata. Vetëm në këtë mënyrë, bashkëpunimi institucional do të arrijë të zbatohet në mënyrë të padiskutueshme frymën e ligjit dhe vullnetin e legjislatorit për të pasur një drejtësi të paanshme, me integritet, të besueshme dhe të papërlyer në afera korruptive apo me ndikime të tjera të paligjshme.

GJETJET KRYESORE

Gjetjet kryesore që konstaton ky raport mbi situatën e institucioneve të drejtësisë dhe të efiçensës së tyre janë të përmbledhura si vijon:

- *Reforma në drejtësi ka krijuar një tjetër realitet për organizimin dhe funksionimin e organeve të drejtësisë, por sfidat që përballen aktualisht kanë të bëjnë, jo vetëm me konsolidimin e institucioneve dhe dhënien e drejtësisë sipas standardeve më të larta, por edhe me rivendosjen e sundimit të ligjit në një nivel të besueshëm, duke çrrënjosur krahas të tjerash, kulturën e pandëshkueshmërisë të funksionarëve publik në konflikt dhe shkelje flagrante me ligjin;*
- *Institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, krahas sfidave me vonesat në përfundimin brenda afateve ligjore të misionit të tyre, kanë detyrimin të zbatojnë të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, për të ndjekur deri në fund procedurat e referimit të çdo shkelje ligjore të konstatuar për subjektet e rivlerësimit kalimtar në organin e prokurorisë, duke bashkëpunuar ngushtë për secilin rast dhe gjetje të kundraligjshme;*
- *Institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duhet të kryejnë një proces të riformatimit të të gjithë vendimeve të tyre të shkarkimit nga detyra për subjektet e rivlerësimit, duke selektuar ato raste kur motivet e largimit kanë patur shkelje, të cilat përbëjnë dyshime të arsyeshme për konsumimin e elementeve të veprave penale gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e tyre;*
- *Institucionet e tjera publike që përfshihen në hetimet e thelluara të subjekteve të rivlerësimit gjatë procedurave të vettingut, duhet të jenë më të angazhuara për të zbuluar dhe ndjekur çdo shkelje flagrante të ligjit, duke zbatuar kompetencat që ju njeh ligji për të ndërmarrë masa me karakter administrativ, disiplinor dhe referime penale sipas rastit;*
- *Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë janë institucione me rëndësi, jo vetëm për të ndjekur procesin e vettingut dhe rezultatet konkrete të tij për përmirësimin e besimit në publik, por edhe për të përqasur indikator të matshëm dhe të unifikuar të këtyre rezultateve me anë të raportimeve dhe statistikave të dedikuara për këtë qëllim;*
- *Struktura e Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit megjithë ngarkesat në rritje në punën e saj, ka detyrimin që të vijojë hetimin e subjekteve të rivlerësimit të shkarkuar nga vetingu, duke ndërmarrë veprime me iniciativën e tij në të gjitha ato raste, ku megjithë flagrancën e shkeljeve të konstatuara nga organet e tjera nuk janë referuar kallëzime penale konkrete pranë këtij organi. Kjo veprimtari duhet të fuqizohet edhe nëpërmjet hetimeve proaktive që ndihmojnë së tepërmi realizimin në kohë dhe me cilësi të luftës kundër pandëshkueshmërisë të funksionarëve të shkarkuar nga sistemi i drejtësisë;*
- *Gjykatat dhe Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, duhet të tregojnë një gatishmëri më të madhe për të ndjekur qoftë nëpërmjet kallëzimeve penale, qoftë me iniciativën e tyre, rastet kur shkarkimi nga detyra i subjekteve të rivlerësimit kalimtar kanë qenë për shkaqe që përmbajnë dyshime të arsyeshme për konsumim*

të veprave penale, duke i hetuar dhe gjykuar deri në fund me integritet dhe paanshmëri;

- *Institucioni i Komisionerëve Publikë, pavarësisht kompetencave që ju njihen nga dispozitat ligjore organike mbi organizimin dhe funksionimin e tyre, kanë për detyrë të forcojnë më tej nismat me vetiniciativë, në rastet kur gjatë konstatimit të shkeljeve, krahas ekspertizës së thelluar të shqyrtimit të vendimeve të KPK, të referojnë raste të veçanta flagrante të shkeljeve ligjore me elemente të veprave penale që konstatohen në mënyrë flagrante;*
- *Miratimi i një metodologjie të re për investigimin e rasteve të hetimit pasuror për subjektet e rivlerësimit të shkarkuar nga vetingu, është një alternativë shumë efektive për të zbuluar më tej shkaqet e pamjaftueshmërisë së burimeve të paligjshme të pasurimit të tyre, të cilat mund të orientojnë më mirë organet ligjzbatuese në çështjet e korrupsionit dhe pastrimit të produkteve të veprës penale;*

I. ANALIZË E KUADRIT LIGJOR MBI SHKARKIMIN DHE NDJEKJEN PENALE TË SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR PËR ÇËSHTJET PASURORE

Në ndryshimet Kushtetuese që ndodhën në vitin 2016, reforma në drejtësi u përfshi në mënyrë integrale në disa nene të Kushtetutës, duke rregulluar në mënyrë të veçantë, krahas të tjerash, ngritjen dhe vënien në funksionim të institucioneve për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe duke përcaktuar objektin kryesor të punës së tyre.

Në përmbajtjen e Kushtetutës⁶ subjektet e rivlerësimit kalimtar i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Po ashtu, Kushtetuta parashikon se nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën. Në rastet kur subjekti fsheh ose prezanton në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Në dallim nga komponenti pasuror i mësipërm, Kushtetuta⁷ parashikon që, për komponentin e kontrollit të integritetit, provat e mbledhura në kuadër të “vetting-ut” nuk mund të përdoren në proceset e mëtejshme të ndjekjes penale të subjekteve, veçanërisht nëse identifikohen kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Ndërsa për komponentin e aftësive profesionale, ato trajtohen si indikatorë për dhënien e masave disiplinore administrative, pasi identifikohet mungesa e kualifikimit për të kryer funksionin ose mangësi të dukshme profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Nga analiza e mësipërme rezulton se vetëm çështjet pasurore përbëjnë objekt për ndjekje të mëtejshme penale.

Gjithashtu, Kushtetuta⁸ parashikon se pas vendimit të KPK, Kolegji i Pavarur i Apelimit, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Nëkëto raste, subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim vetëm në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁶ Aneksi Kushtetutës, Neni D miratuar me Ligjin Nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

⁷ Aneksi Kushtetutës, Neni DH miratuar me Ligjin Nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

⁸ Aneksi Kushtetutës, Neni E miratuar me Ligjin Nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Në dispozitat e mësipërme kushtetuese, vihet re se nuk është parashikuar në asnjë rast sesi veprohet kur nga hetimi administrativ kanë dalë prova që plotësojnë elementet e veprës penale dhe gjithashtu, nuk përcaktohet se cili institucion ka të drejtë të referojë në organin e akuzës këto raste për hetime të mëtejshme. Këto mungesa vihen re edhe në veprimtarinë dhe kompetencat e parashikuara për Komisionerin Publik. Gjithashtu, ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloret⁹ e organizimit dhe funksionimit të institucioneve të rivlerësimit kalimtar nuk përmbajnë parashikime të kësaj natyre.

Një tjetër institucion që përfshihet në bazë të ligjit për të kontrolluar dhe referuar të dhënat pasurore të subjekteve të rivlerësimit është edhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI). Në bazë të legjislacionit në fuqi, deklaratimet e interesave private dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga KPK dhe KPA. Madje ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publik”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.¹⁰

Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, për qëllimet e rivlerësimit, mund të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ose Ministrisë së Drejtësisë, dokumentet për pasuritë në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, dokumentet që përdoren jashtë shtetit nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, ose të dhënat financiare mbi çdo transaksion financiar brenda ose jashtë vendit në përputhje me ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta.

Në përfundim të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm e të arsyetuar dhe sipas rastit, konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti i interesit; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) është kryer fshehtë e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Referuar sa më lartë, ekziston një paradoks ligjor, i cili kërkon zgjidhje juridike pasi krijon standard të dyfishtë në masat që merren për shkeljet e konstatuara.

⁹ Rregullore “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese” miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.07.2017 të mbledhjes së gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 06.06.2018 të mbledhjes së gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2019 të mbledhjes së gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 28.06.2019 të mbledhjes së gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 22, datë 04.11.2020 të mbledhjes së gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 52, datë 21.06.2021 të mbledhjes së gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 84, datë 29.09.2021 të mbledhjes së gjyqtarëve; Rregullore për veprimtarinë e institucionit të Komisionerëve Publikë miratuar nga mbledhja e komisionerëve, datë 4.4.2018;

¹⁰ Neni 32 dhe 33 i ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’;

Konkretisht, në rastet kur deklaruesi nuk është pjesë e kontrollit të rivlerësimit kalimtar, por një zyrtar deklarues i zakonshëm, ILDKPKI për shkeljet e mësipërme, vendos gjobë ndaj kundërvajtësit ose referon çështjen për ndjekje penale në prokurori. Në rastin e verifikimeve pasurore për rivlerësimin kalimtar, ky institucion nuk ndërmerr asnjë masë tjetër ndaj konstatimit të shkeljes, por mjaftohet vetëm me referimin e informacionit pranë KPK ose KPA. Për më tepër që në disa raste, ILDKPKI ka konstatuar shkelje të deklarimit pasuror të subjekteve të rivlerësimit, të cilët në kontrollet e mëparshme vjetore nga vetë ky institucion kanë rezultuar të rregullta. Kjo problematikë është ngritur edhe nga vetë subjektet e rivlerësimit kalimtar gjatë seancave dëgjimore në KPK dhe KPA. Bazuar në analizën dhe informacionet e ILDKPKI, KPK dhe KPA vendosin më pas shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit kur rezulton se ai ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të, si dhe kur konstatohet se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin pasurisë.¹¹

Një problematikë e tillë duhet të evidentohet dhe përmirësohet me procedura të qarta administrative, duke synuar që ILKPKPI të rrisë aktivitetin e pavarur të ndëshkimit administrativ dhe kallëzimeve penale ndaj subjekteve të rivlerësimit, edhe atëherë kur ato janë shkarkuar nga KPA dhe për të cilët nuk është marrë masë shtesë përveç largimit nga sistemi, pavarësisht shkeljes së legjislacionit mbi deklaramin e pasurisë.¹²

Bazuar në Kodin e Procedurës Penale¹³, nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale. Gjithashtu, kur gjatë një procedimi administrativ, zbulohet një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim në prokurori. Një rregull i tillë krijon detyrimin për të gjithë organet administrative (si ILDKPKI, KPK, KPA apo Komisioneri Publik) për të referuar në prokurori të gjitha rastet kur nga hetimi administrativ i kryer gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar ka dyshime se janë konsumuar elementet e veprës penale. Mosveprimet për të kallëzuar penalisht subjekte apo vepra penale konkrete ngarkon çdo individë me përgjegjësi penale, pasi ata, përveç akuzës për moskallëzim krimi, mund të ndiqen penalisht edhe për vepra penale të shpërdorimit të detyrës, moskallëzimit të krimit deri dhe në forma të bashkëpunimit në fshehjen e pasurisë apo fitimit të të ardhurave në mënyrë të paligjshme.

Veprat penale, për të cilat mund të ndiqen penalisht subjektet e rivlerësimit të shkarkuar kanë një spektër të gjerë, nisur nga gjetjet gjatë fazës së hetimit administrativ në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në këto raste, institucionet e

¹¹ Neni 61 i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

¹² Ligji nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar;

¹³ Neni 281 i ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar);

kontrollit të pasurisë dhe ato të rivlerësimit kalimtar kanë detyrimin të trajtojnë me përgjegjësi provat e mbledhura, të kualifikojnë veprat penale konkrete në ngarkim të subjekteve dhe ti referojnë ata për hetime të mëtejshme në organin e akuzës.

Në bazë të Kodit Penal¹⁴, veprat kryesore për të cilat gjendet përputhshmëri për kallëzim, nisur nga problematikat e konstatuara për çështjet pasurore të subjekteve të rivlerësimit, kanë lidhje kryesisht me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, fshehjen ose deklarimin e rremë të pasurisë si dhe evazionin fiskal. Për të gjithë këto raste, hetimet duhet të jenë të thella, me grup ekspertësh dhe në bashkëpunim të ngushtë midis të gjitha institucioneve që mbulojnë shërbimet publike respektive.

Konkretisht, bazuar në Kodin Penal¹⁵, pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale përbëhet nga disa forma, ku më kryesoret që gjejnë zbatim në rastet e "*vetting-ut*" pasuror janë ato të këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, fitimit ose zhvendosjes së pronësisë duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale, kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave, investimit të pasurive të paligjshme në veprimtari ekonomike ose financiare, etj. Për rastet e mësipërme, Kodi Penal parashikon dënime nga 5 deri në 15 vjet burg.

Një tjetër dispozitë¹⁶ në Kodin Penal që rëndon pozitat e subjekteve të rivlerësimit të shkarkuar për probleme pasurore, ka të bëjë me fshehjen dhe deklarimin e rremë të pasurive dhe interesave private të zyrtarëve publik. Në këtë rast, refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimin e pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj. Ndërsa fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Lidhur me evazionin fiskal, i cili duhet të merret në konsideratë në hetimet penale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar të shkarkuar, ligji penal¹⁷ parashikon midis të tjerash se fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, dorëzimi i deklaratave ose informacioneve të rreme me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përlllogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se pesë milionë lekë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet dhe kur vlera e detyrimit është më e lartë se 8 milion, dënimi me burgim shkon nga katër deri në tetë vjet.

¹⁴ Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi penal i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar);

¹⁵ Neni 287 i ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi penal i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar);

¹⁶ Neni 257/a i ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi penal i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar);

¹⁷ Neni 180 i ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi penal i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar);

Nëse përmendim veprat penale të mësipërme në një të njëjtën anë dhe nevojën për zbatimin e parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së fenomenit të pandëshkueshmërisë në anën tjetër, legjislacioni penal i ofron të gjitha mundësitë dhe hapësirat e nevojshme që subjektet e rivlerësimit kalimtar të shkarkuar për çështje pasurore të vihen përpara akuzës dhe përgjegjësisë penale.

Vendosmëria dhe dedikimi për të ndërmarrë hetime dhe gjykime mbi shkeljet e mësipërme, të cilat identifikohen fillimisht gjatë hetimit administrativ të rivlerësimit kalimtar dhe materializohen si akuza dhe çështje konkrete gjatë procesit penal, është jo vetëm një detyrim ligjor, por edhe një masë konkrete me karakter parandalues për cilindo magjistrat në detyrë që ka nxitje të përfshihet në afëra të kundërligjshme.

II. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË PAVARUAR TË KUALIFIKIMIT NË RIVLERËSIMIN KALIMTAR DHE NDJEKJEN PENALE TË SHKELJEVE TË KONSTATUARA

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) është institucioni që ushtron veprimtarinë e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke u vendosur në hierarki si organ i hetimit administrativ të shkallës së parë. Ky institucion ka prerogativa të mirëpërcaktuara, është i pavarur dhe i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit gjatë veprimtarisë së tij, duke krijuar garancinë për një standard të lartë kontrolli, hetimi dhe ndëshkimi disiplinor ndaj subjekteve të rivlerësimit.

Nga të dhënat e përcjella nga KPK në kuadër të kërkesës për informim të paraqitur për qëllime të këtij studimi,¹⁸ KPK ka informuar se ky institucion gjatë gjithë veprimtarisë së tij, ka referuar për ndjekje penale gjithsej 4 magjistratë, ndër të cilët 2 prokurorë dhe 2 gjyqtarë, të cilët gjatë fazave të hetimit dhe konkluzioneve të tyre, janë gjendur në shkelje të karakterit penal. Gjithashtu, KPK sqaron se nuk ka kompetenca për të hetuar gjyqtarët apo prokurorët në lëmin penal, por vetëm për të kryer hetim të thelluar administrativ në aspektet e integritetit, pasurisë dhe profesionalizmit.

KPK informon gjithashtu se është organ i shkallës së parë të rivlerësimit kalimtar dhe vendimet e tij për shkarkim nuk janë të formës së prerë dhe nuk mund të referohen automatikisht për ndjekje të mëtejshme në organin e akuzës. Pavarësisht kësaj, KPK garanton në përgjigje se nëse gjatë hetimit administrativ konstatohen elementë të dyshimtë, konstatimet i dërgohen prokurorisë për të vlerësuar, rast pas rasti, nëse ato përbejnë apo jo vepër penale.

Në vështrim të përgjithshëm, prononcimi i KPK i është përmbajtur normave ligjore të veprimtarisë së saj dhe detyrimit për kallëzim penal ndaj rasteve që konstatohen me shkelje. Por nëse i referohemi shifrave konkrete, veprimet për referim në fushën penale duhet të ishin në numër shumë herë më të lartë, gjë që do tregonte një intensifikim të punës së tyre në marrëdhënie me organin e akuzës për të çuar deri në fund ndëshkimin e subjekteve të rivlerësimit.

Nga të dhënat e përgjithshme të veprimtarisë së KPK¹⁹ gjatë gjithë viteve të aktivitetit të këtij institucioni, rezultoi se në 191 vendime të shkarkimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, 163 vendime kanë qenë për shkaqe pasurore.²⁰ Në këtë kontekst, problematikat dhe shkeljet që janë konstatuar, pavarësisht specifikave në disa raste, kanë qenë të plota dhe të detajuara, mbështetur në ekspertizë profesionale të kualifikuar. Shifrat tregojnë qartë se KPK ka pasur mundësi në shumë raste (të trajtuara në vijim) të referonte jo vetëm të dhënat përkatëse në organin e akuzës për vleftësim, por edhe kallëzime të mirëfillta

¹⁸ Shkresa 2666/1, datë 07.07.2022, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (përgjigje kërkesës për informacion ALTRI)

¹⁹ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2022/05/RAPORTI-STATISTIKOR-SHKURT-2018-PRILL-2022.pdf> (fq 1)

²⁰ Përlllogaritje statistikore nga të dhënat e KPK të publikuara në www.kpk.al

penale në numër të konsiderueshëm. Në këtë aspekt, kjo nismë nuk mund të pengohet apo të kishte barrierë ligjore faktin që ky organ është shkalla e parë e kontrollit të thelluar pasuror, për sa kohë që shumë prej gjetjeve në çështjet e hetuara nga ana e tij kanë qenë të qarta dhe me shkelje flagrante.

Nganjëherë, mosveprimi në kohë për të referuar për vleftësim penal apo për të kallëzuar penalisht subjektet e rivlerësimit, mund të ezaurojë kohën deri në limitet e parashikuar nga ligji që mbërrinë deri në rrezikun e parashkrimit të ndjekjes penale. Duke iu referuar detyrimit ligjor që buron nga legjislacioni i lartpërmendur procedural penal, KPK i gëzon të gjithë atributet, që edhe pse organ i hetimit administrativ, të marrë vendime kolegjiale të ndërmjetme për referimin e elementeve të dyshuar të veprës penale pranë organit të akuzës për hetime të mëtejshme. Në këtë rast, nuk konsiderohet e nevojshme ndërhyrja për ndryshime ligjore, por vetëm për përcaktime të standardizuara të veprimeve konkrete në aktet nënligjore që rregullojnë punën e KPK duke përcaktuar saktë dhe me rregulla të qarta, se në cilat raste KPK ka detyrimin të përmbushë kërkesat e legjislacionit penal për të referuar çështjet për ndjekje penale, duke përcaktuar edhe afatet konkrete dhe momentin e vlerësimit për referim të shkeljeve të konstatuara.

III. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË PAVARUR TË APELIMIT NË RIVLERËSIMIN KALIMTAR DHE NDJEKJEN PENALE TË SHKELJEVE TË KONSTATUARA

Krahas kompetencës për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të KPK, për të cilat konsiderohet shkalla e dytë përfundimtare e procesit të rivlerësimit kalimtar, KPA ka edhe juridiksion të shqyrtojë shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë. Për të dyja këto funksione, KPA ka detyrimin procedural penal, që në rastet e konstatimit të shkeljeve të dyshuara, të kryejë referim apo kallëzim pranë organit të akuzës.

Nga të dhënat e përcjella nga KPA në kuadër të kërkesës për informim të paraqitur për qëllime të këtij studimi,²¹ KPA informon se ky institucion gjatë gjithë veprimtarisë së tij, nuk ka referuar për ndjekje penale pranë Strukturës së Posaçme për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin (SPAK) çështje që lidhen me subjektet e rivlerësimit kalimtar. KPA sqaron gjithashtu se, në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit dhe nën dritën e neneve 179/b, pika 5 të Kushtetutës dhe nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ky organ ka detyrë vetëm të shqyrtojë ankimet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit apo Komisionerit Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në përgjigjen për informacion, KPA sqaron se kallëzimet penale nuk janë detyrë apo tagër ekskluziv i institucioneve të rivlerësimit, e për pasojë, edhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, por vendimet e saj të arsyetuara janë publike, lehtësisht të aksesueshme nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit dhe mund të jenë/bëhen objekt shqyrtimi nga organet e ndjekjes penale me iniciativën e tyre “*ex officio*”. Për rrjedhim, kuptohet lehtësisht se natyra e punës së KPA në lidhje me ndjekjen e mëtejshme të rasteve që përmbajnë elemente të veprës penale është pasive, duke i lënë vendin për ndjekje jo vetëm organit të akuzës, por edhe të kallëzimeve nga palë të interesuara apo individë.

Nga të dhënat e KPA rezulton se, që nga fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (mars 2018 deri maj 2022) janë marrë gjithsej 131 vendime për juridiksionin e rivlerësimit kalimtar²², ndër të cilat 91 vendime kanë qenë për shkarkim nga detyra duke ndryshuar vendimin e KPK ose lënien në fuqi të vendimeve të KPK për shkarkim nga detyra. Nga 91 vendime, rezulton se 82 vendime kanë qenë për çështje të karakterit të pasuror²³. Në këtë rast, problematikat dhe shkeljet që janë evidentuar, pavarësisht opinioneve të

²¹Komunikim elektronik i KPA me ALTRI, në kuadër të informacioneve të kërkuara zyrtarisht me shkresën nr. 967 prot, datë 28.06.2022;

²² Të dhëna të marra nga faqja zyrtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

²³ Të dhëna të marra nga faqja zyrtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelit www.kpa.al/vendime

ndryshme në disa raste, kanë qenë të qarta dhe të detajuara me ekspertizë profesionale të kualifikuar dhe rakorduar midis ekspertëve të KPK, KPA dhe ILDKPKI.

Mosveprimet e KPA për të referuar për ndjekje penale shumicën e çështjeve në të cilat është vendosur shkarkimi i subjektit të rivlerësimit për motive pasurore, vlerësojnë se nuk përputhen me detyrimet e Kodit të Procedurës Penale²⁴, të cilat e detyrojnë këtë institucion që të veprojë në rastet kur konstaton vepra penale apo elemente të dyshuar si të tilla. Ashtu sikundër do të analizojmë edhe në vijim të këtij studimi, ekzistojnë një mori vendimesh, të cilët në mënyrë të qartë përmbajnë elemente të veprave penale. Madje argumentet e KPA në brendinë e këtyre vendimeve kanë qenë mjaft të bazuara për të dalë në përfundime me efekte të drejtpërdrejta të përgjegjësive penale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar të shkarkuar për motive pasurore.

Në këndvështrimin e mësipërm, KPK në dallim nga KPA, pavarësisht numrit të pakët të çështjeve që ka referuar për ndjekje penale, e ka zbatuar qoftë dhe minimalisht rolin e tij si organ i hetimit të thelluar administrativ, rol i cili nuk duhet të përfundojë misionin e tij thjeshtë me marrjen e një vendimi, por dhe duhet të vazhdojë me ndjekjen e mëtejshme të çështjes dhe përballjen e subjekteve me përgjegjësitë penale që ju ngarkohet në bazë të ligjit dhe provave të administruara. Në këtë rast është shumë e rëndësishme që qendrimet midis këtyre dy institucioneve të unifikohen në zbatim të ligjit procedural penal, duke përcaktuar rregulla të qarta për mënyrën e veprimit lidhur me çështjet që përmbajnë elemente të veprave penale.

²⁴ Neni 281 i Ligjit Nr.7905, datë 21.3.1995 Kodi penal i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar);

IV. VEPRIMTARIA E KOMISIONERIT PUBLIK NË RIVLERËSIMIN KALIMTAR DHE NDJEKJEN PENALE TË SHKELJEVE TË KONSTATUARA

Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP), si përfaqësues i interesit publik, ka kompetenca për të ankimuar në KPA vendimet e KPK²⁵. IKP përgatit gjithashtu, raportin me shkrim me arsyet e refuzimit për moszbatimin e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) për të paraqitur ankim në KPA.²⁶

IKP raporton²⁷ se nga shkurti i vitit 2018 deri në korrik 2022 ka shqyrtuar gjithsej 536 vendime të KPK dhe ka depozituar 66 ankime pranë KPA, nga të cilat për 55 ankesa është dhënë vendim, ndërsa pjesa tjetër e ankimeve është ende në proces. Në vijim të punës së këtij institucioni, lidhur me hetimin e rasteve konkrete, IKP ka bashkëpunuar ngushtë edhe me publikun, duke pranuar 1708 denoncime për të dhëna që mund t'i shërbejnë zbardhjes së shkeljeve të ndryshme nga ana e subjekteve të rivlerësimit kalimtar.

IKP është institucion i administratës publike, pjesë e organeve që ushtrojnë procedurat e "*vetting-ut*" dhe si e tillë, i nënshtrohet të njëjtave detyrime, ashtu sikundër edhe organet e tjera, për të referuar raste kur dyshon që fakte të caktuara përmbajnë elemente të veprave penale. Ky është një detyrim ligjor që duhet të ndiqet jo vetëm si një prerogative e përhershme dhe e vazhdueshme e punës së Komisionerëve Publike, por edhe duhet parashikuar në aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e IKP. Krahas shqyrtimit të vendimeve të KPK, të cilat kanë pasur të dhëna sensitive për t'u kallëzuar penalisht në organin e akuzës, IKP i ka të gjitha mundësitë që të verifikojë, shfrytëzojë dhe referojë për hetime të mëtejshme penale edhe denoncimet e publikut, për raste të cilat shfaqin në mënyrë flagrante elemente të veprës penale.

²⁵ Neni 63 i ligjit nr. 84/2016;

²⁶ Aneksi i Kushtetutës, neni B "Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit";

²⁷ <http://ikp.al/wp-content/uploads/2022/08/Raport-statistikor-shkurt-2018-korrik-2022-final.pdf>

V. VEPRIMTARIA E STRUKTURËS SË POSAÇME PËR KRIMIN E ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIN (SPAK) PËR HETIMIN E SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR.

Kushtetuta dhe Kodi i Procedurës Penale²⁸, parashikojnë se SPAK ka kompetencë të hetojë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi²⁹, SPAK ka gjithashtu kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të saj, duke kërkuar nga gjyqtarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

Ligji³⁰ parashikon se të gjitha organet e pushtetit shtetëror dhe të gjitha subjektet juridike, të cilat, në kryerjen e aktiviteteve të tyre, vijnë në dijeni për rrethana dhe të dhëna për vepra penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, janë të detyruar t'i referojnë këto rrethana ose të njoftojnë menjëherë Byronë Kombëtare të Hetimit ose Prokurorinë e Posaçme.

Nga të dhënat e përcjella nga SPAK në kuadër të kërkesës për informim të paraqitur për qëllime të këtij studimi³¹, SPAK është përgjigjur me informacione të detajuara për veprimtarinë e saj, lidhur me hetimin e subjekteve të rivlerësimit kalimtar, duke pasqyruar sipas viteve të gjitha çështjet që janë depozituar pranë saj dhe hetimet që ky institucion ka ndjekur, deri në kërkesat përkatëse për gjykim, mosfillimin apo pushimin e tyre.

Bazuar në informacionet e paraqitura rezulton se, përgjatë vitit 2019, pranë SPAK, janë referuar dhe regjistruar 6 kallëzime penale për gjyqtarë dhe prokurorë ndaj të cilëve është zhvilluar procesi i rivlerësimit ose janë dorëhequr përpara se ti nënshtroheshin këtij procesi. Ndërkohë gjatë vitit 2020, pranë SPAK, janë referuar dhe regjistruar 39 kallëzime penale për gjyqtarë dhe prokurorë ndaj

²⁸ Neni 135 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale;

²⁹ Neni 9 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 95/2016 datë 6.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

³⁰ Neni 28 i ligjit nr. 95/2016 datë 6.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

³¹ Shkresa për informacione të SPAK dërguar ALTRI në rrugë elektronike datë 13.07.2022;

të cilëve është zhvilluar procesi i rivlerësimit ose janë dorëhequr përpara se ti nënshtroheshin këtij procesi.

Në vitin 2021, pranë SPAK, janë referuar dhe regjistruar 63 kallëzime penale për gjyqtarë dhe prokurorë ndaj të cilëve është zhvilluar procesi i rivlerësimit ose janë dorëhequr përpara se ti nënshtroheshin këtij procesi, ndërsa në vitin 2022, pranë SPAK, janë referuar dhe regjistruar 26 kallëzime penale për gjyqtarë dhe prokurorë ndaj të cilëve është zhvilluar procesi i rivlerësimit ose janë dorëhequr përpara se ti nënshtroheshin këtij procesi.

SPAK sqaron se për 6 kallëzimet e regjistruar për vitin 2019, është vendosur mosfillimi i procedimit penal me vendimmarrje të prokurorëve të posaçëm. Ndërkohë që nga totali prej 39 kallëzimesh të regjistruara gjatë vitit 2020, për 29 prej tyre është vendosur mosfillimi i procedimit penal me vendimmarrje të prokurorëve të posaçëm. Për vitin 2020, është dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim 1 procedim penal me 1 gjyqtar, nën hetim për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal.

SPAK informon gjithashtu se përgjatë vitit 2020, janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 2 procedime penale me 1 prokuror dhe 1 gjyqtar, me cilësinë e të pandehurve, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 186/1, 319/ç, 179/a, 257/a dhe 287 të Kodit Penal. Ndërkohë që nga totali prej 63 kallëzimesh të regjistruara gjatë vitit 2021, për 47 prej tyre është vendosur mosfillimi i procedimit penal me vendimmarrje të prokurorëve të posaçëm. Ndërsa për gjatë vitit 2021, është dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim 1 procedim penal me 1 gjyqtar, nën hetim për veprën penale të parashikuar nga nenet 246 dhe 248 të Kodit Penal dhe janë dërguar për gjykim, 2 procedime penale me 2 gjyqtarë me cilësinë e të pandehurit, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal.

Lidhur me vitin 2022, SPAK informon se deri në korrik 2022 nga totali prej 26 kallëzimesh, për 25 prej tyre është vendosur mosfillimi i procedimit penal me vendimmarrje të prokurorëve të posaçëm, ndërsa janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, 3 procedime penale me 2 gjyqtarë dhe 1 prokuror me cilësinë e të pandehurit, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 257/a/2, 319/ç, 257/a dhe 180/1 të Kodit Penal.

SPAK sqaron gjithashtu se nga kallëzimet për vitin 2019, 6 prej tyre janë paraqitur nga shtetas, ndërsa për vitin 2020, 39 kallëzime të regjistruara janë paraqitur po nga individë. Ndërkohë që nga totali prej 63 kallëzimesh të regjistruara gjatë vitit 2021, 57 prej tyre janë paraqitur nga shtetas, 4 prej tyre nga persona juridik, 1 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe 1 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë. Për vitin 2022, nga totali prej 26 kallëzimesh të regjistruara, 21 prej tyre janë paraqitur nga shtetas, 2 prej tyre nga persona juridikë dhe 2 kallëzime janë përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme.

Në veprimtarinë e SPAK, vërehet një prani e lartë kallëzimesh penale për subjektet e rivlerësimit të paraqitura nga shtetas, si dhe një numër po ashtu i konsiderueshëm i çështjeve të pushuara ndaj tyre, që janë të juridiksionit të posaçëm. Ajo që konstatohet është edhe fakti që në asnjë rast kallëzimet nuk janë paraqitur nga organet e rivlerësimit kalimtar. Po ashtu një konstatim tjetër është se, SPAK nuk ka referuar asnjë rast për të cilin hetimet të kenë nisur me iniciativën e saj.

VI. VEPRIMTARIA E GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË DHE APELIT KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT PËR GJYKIMIN DHE DËNIMIN E SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR

Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Shkallës së Parë dhe të Apelit janë institucione kompetente për të shqyrtuar dhe dënuar penalisht çdo veprë penale për dy fushat e mësipërme, si dhe rastet kur ngrihet akuzë penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, apo kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur edhe nëse ai është zyrtar publik ose zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit³².

Nga të dhënat e përcjella në kuadër të kërkesës për informim të paraqitur për qëllime të këtij studimi³³, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit ka informuar se për subjektet e rivlerësimit kalimtar ka pranuar së fundi kërkesën për gjykim për dosjen penale datë 23.05.2022 me të pandehur ish gjyqtarin B.D, akuzuar për veprën penale të "Refuzimit për deklaram, mosdeklarimit apo fshehjes ose deklarimit të rremë" parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal. Ky subjekt i rivlerësimit kalimtar e kaloi shkallën e parë të *vetting-ut*, por u rrëzua nga një vendim i KPA që e lidhi këtë subjekt përmes një kontrate me OSHEE, me një apartament në Durrës, që pretendohet fillimisht se ishte i vëllait të tij.

Po ashtu kjo gjykatë sqaron se është ende në gjykim dosja penale datë 31.07.2021 me të pandehur ish gjyqtarin F.L akuzuar për veprën penale të "Refuzimit për deklaram, mosdeklarimit apo fshehjes ose deklarimit të rreme" parashikuar nga neni 257/ a i Kodit Penal. KPA la në fuqi vendimin e shkarkimit të KPK, i cili e gjeti subjektin të papërshtatshëm për detyrën e gjyqtarit pas një karriere të gjatë në sistemin e drejtësisë për shkak të posedimit të një pasurie të pajustificuar me burime të ligjshme të të ardhurave.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin ka informuar gjithashtu se ka në gjykim dosjen penale nr. 39, ku kërkohet pushimi i hetimeve nga ana e SPAK, me të akuzuar ish gjyqtarët, A.M, A.Z, B.I, E.I, G.D, T.N dhe Xh.Z, për veprën penale të "Refuzimit për deklaram, mosdeklarimit apo fshehjes ose deklarimit të rreme" parashikuar nga neni 257/ a i Kodit Penal. Kjo gjykatë ka informuar më tej se me Vendimin e datës 09.12.2021 është vendosur sekuestrimi i pasurisë se ish gjyqtarit A.TH. Kjo masë ka ardhur si rrjedhojë e vendimeve të KPK dhe KPA, të cilat kanë zbuluar midis të tjerash mospërputhje dhe deklarim të rremë të deklaratave periodike, deklaratave gjatë kontrollit dhe

³² Neni 135 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

³³ Informacion përgjigje në rrugë elektronike dërguar Qendrës ALTRI datë 31.07.2022

dokumenteve të administruara nga institucionet publike për një numër pasurish të paluajtshme në Tiranë dhe Shkodër, si dhe mungesë burimesh financiare.

Së fundi, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, me Vendimin e datës 16.02.2022 ka vendosur pushimin e hetimit për ish prokurorin A.L, ndërkohë që KPK dhe KPA kishin zbuluar më herët mospërputhje dhe deklaram të rremë të deklaratave periodike, deklaratave gjatë kontrollit dhe dokumenteve të administruara nga institucionet publike, për një numër pasurish të paluajtshme në Tiranë, si dhe mungesë burimesh financiare.

Nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin³⁴, rezulton se që nga dhjetori i vitit 2019 që përkon me fillimin e punës së këtij institucioni dhe deri më sot nuk është regjistruar për gjykim asnjë çështje që ka lidhje me subjektet e rivlerësimit kalimtar të shkarkuar nga detyra.

Referuar sa më lart, konstatojmë se pavarësisht hetimeve dhe gjykimeve të ndërmarra që nga fillimi i punës nga ana e strukturave të posaçme kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit, deri më sot nuk kemi asnjë subjekt të rivlerësimit kalimtar të shkarkuar, i cili të jetë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë për veprat penale të kryera.

³⁴ Shkresa nr.532 datë 06.07.2022 GJKKO dërguar për informacion Qendrës ALTRI;

VII. VEPRIMTARIA E PROKURORIVE DHE GJYKATAVE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR HETIMIN DHE GJYKIMIN E SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR

Gjykatat dhe Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bazë të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale për të gjitha ato vepra penale dhe subjekte të rivlerësimit kalimtar të shkarkuar nga organet e "vetting-ut", të cilët nuk i nënshtrohen hetimit dhe gjykimit nga juridiksioni i posaçëm, siç parashikon Kushtetuta³⁵.

Që nga viti 2018 dhe deri në korrik 2022³⁶, të dhënat për hetime, gjykime apo dënime nga gjykatat dhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm nuk identifikojnë raste të personalizuar me të dhëna të sakta për subjekte të rivlerësimit të shkarkuar për çështje pasurore, ndaj të cilëve ekzistojnë elementë të veprave penale për shkelje kryesisht të deklarimeve pasurore apo evazion fiskal. Kjo mungesë e të dhënave statistikore ka qenë një boshllëk, e cila është ngritur edhe si problematikë nga Kuvendi i Shqipërisë që duhet të gjejë zgjidhje sa më shpejtë nga Prokurori i Përgjegjshëm³⁷, në kuadër të raportimeve të unifikuara dhe të standardizuara që ai duhet të dorëzojë në Kuvendin e Shqipërisë mbi punën e institucionit që ai drejton dhe gjendjes së kriminalitetit në tërësi.

Një teknikalitet i tillë, por që mbart shumë rëndësi në planin e përgjithshëm të efikasitetit të organeve të drejtësisë dhe evidentimit real të luftës kundër fenomenit të pandëshkueshmërisë së funksionarëve publik, vlerësojmë se duhet të realizohet edhe nga ana e organeve gjyqësore. Një vëmendje e shtuar kërkohet edhe nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të unifikuar dhe standardizuar mënyrën e raportimit të veprimtarisë së gjyqësorit për të pasur të dhëna të posaçme për ndjekjen e rasteve të subjekteve të rivlerësimit të shkarkuar që gjykohen apo dënohen penalisht nga ana e këtyre organeve.

Një shifër e përgjithshme, por që ngre shqetësim për mënyrën si është trajtuar nga ana e organeve të hetimit dhe atyre gjyqësor është publikuar nga vetë Ministri i Drejtësisë Z. Ulsi Manja. Në një reagim publik³⁸ ai ka deklaruar se, që nga nisja e procesit të "vetting-ut", 19 gjyqtarë dhe prokurorë janë kallëzuar në prokurori dhe nuk ka asnjë informacion se çfarë është bërë me këto referime. Ndërkohë që nga të dhënat që figurojnë aktualisht, rezulton se është në hetim vetëm një çështje në Prokurorinë Durrës ndaj një ish drejtuesi i prokurorisë, ndërkohë që nuk ka asnjë rast të dënimit penal për subjektet e rivlerësimit të shkarkuar apo ata të larguar me dorëheqje.

³⁵ Neni 135/2 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

³⁶ Të dhëna të hulumtuara nga kërkuesit e këtij studimi;

³⁷ Urdhëri Nr. 78 datë 09.07.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm për miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021;

³⁸ Deklaratë zyrtare e Ministrit të Drejtësisë datë 11.05.2022 (<http://24-ore.com/?p=190407>);

Një tjetër shqetësim që ngrihet me të drejtë në këto raste, janë edhe afatet e hetimit dhe gjykimin për subjektet e rivlerësimit kalimtar të shkarkuar. Referuar Kodit të Procedurës Penale³⁹, ka afate për ushtrimin e ndjekjes penale dhe po t'u referohemi atyre për veprën penale të deklarimit të rremë apo fshehje të burimeve financiare rrezikon që këto vepra të parashkruhen, nëse nuk vihet në lëvizje prokuroria. Detyra e organit të akuzës në këtë rast nuk varet nga kallëzimet që referohen nga individët apo institucionet, por edhe nga vullneti për ti nisur kryesisht vetë këto raste. Për këtë qëllim, Kuvendi i Shqipërisë ka kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm që të ketë më shumë hetime me iniciativë për të rritur performancën e këtij institucioni kundër paligjshmërisë së zyrtarëve publik⁴⁰.

Mosveprimet apo vonesat në hetimin dhe gjykimin në kohë të subjekteve të rivlerësimit të shkarkuar apo ata të larguar me dorëheqje, duke i lënë ata aktualisht jashtë përgjegjësisë penale, forcon jo vetëm kulturën e pandëshkueshmërisë në rradhët e magjistratëve, por kompromenton si të pavlerë edhe hetimet e thelluara, shkeljet e konstatuara dhe vendimet e dhëna nga ana e institucioneve të kontrollit të rivlerësimit kalimtar. Për këtë shqetësim, nuk kanë qenë të pakta edhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë për gjyqësorin në vendin tonë, të cilat me hapjen e negociatave për anëtarësim të Shqipërisë në BE, do të jenë kryefjalë e diskutimeve dhe detyrave edhe në kuadër të Kapitullit 23 dhe 24.

³⁹ Parashkrimi i Ndjekjes Penale / Neni 66 i Kodit të Procedurës Penale;

⁴⁰ Rezoluta e Kuvendit datë 14.06.2021 "Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të Prokurorisë;

VIII. ANALIZA E VENDIMEVE TË SHKARKIMIT TË SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR PËR ÇËSHTJE PASURORE

Nga kërkimet e thelluara në kuadër të këtij studimi për veprimtarinë dhe vendimmarrjen e institucioneve të rivlerësimit kalimtar, u evidentua një numër i konsiderueshëm vendimesh shkarkimi, të cilat nga përmbajtja e tyre deklarojnë në mënyrë të qartë dhe analitike me prova dhe fakte për fshehje të pasurisë së subjekteve të shkarkuar. Këto vendime i përkasin të gjitha viteve të punës së KPK dhe KPA, duke filluar nga 2018 deri në Korrik 2022. Nga të dhënat e tyre, rezulton se këto janë raste që vërtetojnë flagrancën e elementeve të veprës penale dhe mungesën e veprimeve të organeve të *vetting-ut*, atyre hetimore dhe gjyqësore për të kallëzuar, hetuar, gjykuar dhe dënuar këto subjekte për shkeljet ligjore të kryera.

Me qëllim ilustrimin dhe analizën e rasteve që përmbajnë elemente të veprës penale, në vijim po paraqesim 25 çështje të shtrira në kohë për të gjitha vitet e veprimtarisë së KPK dhe KPA. Qëllimi ka qenë të pasqyrojmë një ekstrakt të përgjithshëm të vendimeve të publikuara, pa u ndaluar në emra apo çështje konkrete, por duke bërë vetëm analizën e tyre mbi elemente të ndryshëm të veprave penale që mund të jenë konsumuar dhe që duhen hetuar. Këto vendime do të paraqiten vetëm me konkluzionet e shkeljeve pasurore të konstatuara nga organet e rivlerësimit kalimtar, për të kuptuar në mënyrë të qartë peshën e përgjegjësive dhe nevojën për hetim të mëtejshëm për secilin prej rasteve.

Arsye tjetër e fokusimit tek rastet që do të ilustruajmë në vijim, është edhe fakti që disa prej tyre që i përkasin viteve 2018 ose 2019 rrezikojnë të parashkruhen për ndjekje penale, bazuar në Kodin Penal⁴¹. Deklarimi i rremë me qëllim fshehjen e pasurisë apo shumave të parave, ka qenë një nga veprat penale që është zbuluar më lehtë nga organet e rivlerësimit kalimtar, për shkak se hetimi i thelluar është fokusuar kryesisht mbi analiza dhe metodika të specializuara të inventarit historik të pasurive të subjekteve të rivlerësimit.

Për raste të tjera, ku hyn edhe evazioni fiskal, kjo ka qenë më shumë rrjedhojë e gjetjeve kryesore pasurore, që ka çuar më tej në deklarimin e shkeljeve dhe shkarkimin e tyre. Këto raste janë zbuluar në bashkëpunim me institucione të tjera si ILDKPKI, organet tatimore etj. Për këtë arsye ato nuk duhet të kishin ngelur thjeshtë në ndëshkime disiplinore administrative, por duhet të ishin ndjekur edhe më tej në rrugë gjyqësore penale.

Për çështjet e tjera që janë akoma më të shtuar në numër, motivi i shkarkimit ka qenë për pamjaftueshmëri të ardhurash për pasuritë e deklaruara, çfarë duhet të ishte një tjetër aktivitet i organeve të hetimit për të identifikuar burimet e paligjshme të financimit të subjekteve të rivlerësimit kalimtar. Pamjaftueshmëria e të ardhurave për të justifikuar pasurinë që është vënë re në masën 95%⁴² të subjekteve të shkarkuar, është një konstatim që ngre dyshime të mëdha për një mori veprash penale që mund të jenë konsumuar. Këto vepra mund të kenë

⁴¹ Neni 66 shkronja ç i Kodit Penal (Parashkrimi ndjekjes penale për disa vepra të mësipërme është 5 vjet)

⁴² Gjetje që rezulton nga hulumtimi i vendimeve të publikuara të KPK dhe KPA;

lidhje me aktet korruptive, pastrimin e produkteve të veprës penale, tjetërsimin me qëllim fshehjen e të ardhurave, etj. Të gjitha këto dyshime të arsyeshme në vendimet e KPK dhe KPA, duhet të kishin gjetur më tej gatishmërinë e organeve të hetimit për të zbardhur në mënyrë të plotë burimin e tyre, duke u hetuar kryesisht dhe në thellësi për vepra penale konkrete.

Gjithsesi rastet që do të trajtojmë në vijim, janë çështje të cilat në mënyrë të qartë dhe pa qenë nevoja për hetime të thelluara japin një panoramë të kuptueshme të veprës penale të konsumuar dhe për këtë qëllim veprimet hetimore mund të ishin me të shpejta dhe determinante për dënimin e subjekteve të rivlerësimit kalimtar.

Në Vendimin e korrikut 2018, KPA çmoi se vendimi i KPK ishte i drejtë, pasi në përfundim të hetimit konstatohej se subjekti i rivlerësimit: kishte kryer deklarime të pasakta, kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në shumën prej 20.133.000 lekësh, si dhe kishte kryer fshehje pasurie dhe deklarime të rreme. Në këto konstatime, të cilat bazoheshin edhe në informacionet e mbërritura nga ILDKPKI, si dhe nga analiza financiare e eksperteve të KPK dhe KPA, vërehen lehtësisht elemente të veprës penale⁴³, për të cilat subjekti nuk është referuar dhe nuk është hetuar apo gjykuar penalisht. KPA la në fuqi vendimin e KPK duke e shkarkuar subjektin e rivlerësimit, por asetet e padeklaruara, apo ato të vendosura në mënyrë të paligjshme janë ende në posedim të subjektit.

Me Vendimin e shtatorit 2018, KPA vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikonte bindshëm pasuritë e tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe tregoi një qasje jokorrekte e të pasinqertë në raport me deklarinë e tij në deklaratën e pasurisë. KPA referoi se subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të vazhdueshme në deklaratat e tij të pasurisë në vite, ka kryer deklarime të rreme, duke e çuar trupin gjykues në përfundimin se ai ka fshehur dhe e ka deklaruar në mënyrë të pasaktë pasurinë në vijimësi, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Për këto arsye, KPA, duke lënë në fuqi vendimin e KPK, ka konkluduar se ai ka bërë deklarinë të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, si dhe ka fshehur pjesë të asetëve në posedim, duke i mbuluar me deklarime të pavërteta. Mbi këtë çështje nuk është referuar apo nisur kryesisht ndjekje penale.

Në Vendimin e nëntorit 2018, nga aktet e administruara ne dosje, bazuar në shkresën e ILDKPKI, lidhur me raportin e vlerësimit të pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka kryer fshehje të pasurisë dhe ka kryer deklarinë të rremë.

Për gjithë sa sipër, KPK dhe KPA kanë arritur në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë së paluajtshme, në përdorim të ndërtimit shtesë kati, e përshtatur si njësi banimi e integruar, ka kryer deklarinë të rremë, lidhur me përdorimin e burimeve të ligjshme për realizimin e ndërtimit të shtesës së katit, ka ndërmarë veprime juridike fiktive, lidhur me dhurimin me kusht të një apartamenti drejt personave të tjerë, me qëllim dhënien e imazhit të rremë të zhveshjes nga pronësia e për pasojë, shkarkimin nga përgjegjësia përkatëse për veprimet e mëtejshme, pasi nga provat dhe faktet rezultoi se ka qenë e vijon

⁴³ Neni 257/a i ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (I ndryshuar);

të jetë i vetmi posedues efektiv në këtë pasuri. Për sa me lart, KPK fillimisht dhe me pas KPA ka arritur në përfundimin se veprimet e tij kanë cenuar pastërtinë e figurës dhe etikës së magjistratit, si dhe besimin e publikut ndaj dhe ai është shkarkuar nga detyra. Mbi këtë çështje nuk është referuar apo nisur kryesisht ndjekje penale.

Në Vendimin e nëntorit 2018, KPA në vlerësim të vendimit dhe analizës se KPK për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar se ky subjekt ka ndërmarrë hapa për të fshehur dhe pasqyruar në mënyrë të pasaktë pasurinë e një apartamenti banimi dhe të një garazhi në Tiranë. KPA ka konstatuar se subjekti ka poseduar dhe përdorur në mënyrë të pandërprerë dhe të padeklaruar pasuri të ndodhur jashtë qytetit në të cilin ushtronte veprimtarinë e tij, ndërsa ka përfutur kredi me kushte lehtësuese për shkak të detyrës në qytetin ku kryente detyrën. Në këto kushte, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, dhe për këto arsye ai duhet të shkarkohet nga detyra. Edhe për këtë rast, rezulton se ka pasur prova për konsumimin e elementeve të veprës penale⁴⁴, por kjo çështje nuk është ndjekur penalisht nga ana e organit të akuzës, duke bërë që subjekti t'i shmanget lehtësisht përgjegjësisë ligjore duke vazhduar të përfitojë frute nga pasuritë e vëna në mënyrë të paligjshme.

Në Vendimin e dhjetorit 2018, KPA në përfundim të vlerësimit të gjetjeve të ILDKPI dhe vendimit të KPK, ka evidentuar faktin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë të llojit apartament të ndodhur në Tiranë, nëpërmjet mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratat periodike të viteve 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 dhe në deklaratën e pasurisë vetting, pasuri e cila referuar të dhënave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, ka qenë e regjistruar si pronë në emër të subjektit të rivlerësimit të paktën që nga data 15.03.2012.

Po ashtu, KPA ka dalë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme pasurinë likuiditet të gjendur në një llogari bankare. Sipas vlerësimit të trupit gjykues të KPA, subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte se veprimet juridike të kryera dhe që kanë pasur si pasojë krijimin e kësaj pasurie, janë realizuar në përputhje me ligjin e qëllimin e tij, për pasojë krijimi i kësaj pasurie nuk mbështetet në të ardhura të krijuara në mënyrë të ligjshme. Në këto kushte, KPA ka lënë në fuqi vendimin e KPK duke e shkarkuar atë nga detyra. Ndonëse përfundimet kanë qenë të provuara për elementet e veprës penale⁴⁵, kjo çështje nuk është ndjekur më tej për hetim dhe gjykim nga organet e drejtësisë, duke e lënë subjektin të lirë dhe jashtë përgjegjësisë ligjore.

Në Vendimin e janarit 2019, KPA pasi mori në analizë vendimin e KPK për shkarkim nga detyra dhe formularët e deklarimeve financiare të ILDKPKI, doli në përfundimin se subjekti i rivlerësimit kishte kryer fshehje të pasurisë, duke mos pasqyruar në deklaratën e pasurisë vetting marrëdhënien e tij ligjore me një objekt të ndërtuar pa leje, si dhe një truall me sipërfaqe të konsiderueshme.

⁴⁴ Neni 257/ai ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (I ndryshuar);

⁴⁵ Neni 257/a i ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (I ndryshuar);

Këto veprime, sipas KPA, ishin kryer në kundërshtim të hapur me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", duke e konsideruar këtë situatë faktike si shkelje të rënde të ligjit.

Po ashtu, KPA arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit kishte kryer fshehje të pasurisë edhe në lidhje me mosdeklarimin në deklaratën vetting të pasurisë apartament në Tiranë, për të cilën e ka konsideruar sërish se është pasuri e fshehur e këtij subjekti. Për këto arsye, KPA vendosi shkarkimin e këtij magjistrati nga detyra, por megjithëse të provuara dhe të listuara me dokumentacionin përkatës, shkeljet nuk u ndoqën nga ana e organit të akuzës për hetime të mëtejshme dhe për pasojë subjekti nuk është përballur me akuza dhe pasuritë e zbuluara nga procesi *vettingut* vijojnë të gëzohen nga ana e tij në mënyrë të lirë.

Në Vendimin e prillit 2019, KPA në vijim të shqyrtimit të vendimit të KPK për shkarkim nga detyra, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, kanë bërë deklarim të rremë dhe kanë mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, banesë dhe truall në Tiranë.

KPA deklaroi gjithashtu se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë dhe ka kryer fshehje të pasurisë, apartament në Tiranë, në pronësi të një personi të lidhur me subjektin. Për të dyja këto gjetje të dokumentuara nga analiza financiare dhe pasurore, subjekti është shkarkuar nga detyra, por nuk rezulton që ai të jetë ndjekur penalisht apo gjykuar me akuza penale për shkeljet e mësipërme.

Në Vendimin e prillit 2019, KPA pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe gjetjet në hetimet e thelluara të KPK në vijim të vendimit të këtij organi për shkarkim, doli në përfundimin se pasuria e paluajtshme në Tiranë, nuk justifikohet nga burimet e të ardhurave të deklaruara dhe të dhënat që janë dhënë në lidhje me të kanë qenë të pavërteta. Po ashtu, rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë në likuiditet së bashku me personat e lidhur.

Ndërkohë në lidhje me një transaksionin të dyshimtë të huadhënies në shuma të konsiderueshme në monedhë të huaj, KPA arriti në konkluzionin se pavarësisht se nuk është deklaruar, ajo ka qenë pasuri e subjektit të rivlerësimit dhe e personit të lidhur me të, si shumë që rezulton me mungesë të burimit financiar të ligjshëm. Në përfundim të kësaj analize, KPA vendosi të lërë në fuqi vendimin e KPK, duke u shprehur midis të tjerash se subjekti i rivlerësimit kishte kryer fshehje pasurie. Kjo çështje rezulton se nuk është ndjekur me tej nga ana e organit të akuzës qoftë kryesisht apo me kallëzimin penal të ndonjë institucioni apo individi, duke shmangur deri më sot përgjegjësinë penale të subjektit të rivlerësimit.

Me Vendimin e qershorit 2019, në vijim të lënies në fuqi të vendimit të KPK, KPA argumentoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë dhe fshehje për pasurinë truall dhe banesën mbi këtë truall, e përbërë nga tri kate, e ndodhur në Tiranë, duke pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë. Sipas KPA, një gjetje e tillë sipas ligjit përbën një shkelje të rëndë dhe të dënueshme. Këtë përfundim, KPA e argumentoi edhe për një tjetër pasuri

shtëpi banimi, e përbërë nga dy kate banimi e ndodhur në Tiranë, për të cilën subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, dhe e kishte fshehur atë në deklaratimet e tij. Po ashtu, u evidentua shkelje edhe për pasurinë ndërtim informal mbi një truall në Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka kryer sërish fshehje të pasurisë në deklaratën e pasurisë vetting. Për këto arsye, megjithëse KPA la në fuqi vendimin e KPK për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, kjo çështje nuk është ndjekur më tej për hetim nga ana e organit të akuzës, duke evituar çdo lloj përballje të subjektit me përgjegjësitë ligjore.

Në Vendimin e dhjetorit 2019, u soll fillimisht në vëmendje dhe trajtim nga ana e KPA, veprimtaria hetimore e ILDKPKI, i cili në përfundim të veprimeve të tij verifikuese, nëpërmjet raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar, kishte bërë analizimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti rivlerësues. Mbështetur në aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, ILDKPKI kishte arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit kishte kryer deklaram të pa saktë, nuk kishte burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kishte kryer fshehje dhe deklaram të rreme të pasurisë.

Në konkluzion të analizës për pasuritë e marra në hetim, KPA la në fuqi vendimin e KPK për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, pasi u arrit të provohej se ai ka kryer deklaram të rremë në lidhje me çmimet e shitjes së një apartamenti. Po ashtu, lidhur me pasuritë e luajtshme automjete, KPA vlerësoi se çmimet e shitjes së tyre janë shumë më të larta se çmimet e blerjes edhe pas përdorimit dhe konsumimit, ndaj arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklaram të rremë për këto pasuri. Edhe pse përfundimet kanë qenë të qarta për dyshime të arsyeshme të bazuara në prova për konsumimin e elementeve të veprës penale⁴⁶, kjo çështje nuk është referuar apo të jetë nisur kryesisht si ndjekje penale nga ana e organit të akuzës.

Në Vendimin e janarit 2020, KPA analizoi sërish me prova dhe fakte gjetjet e vendimit të mëparshëm të KPK për shkarkimin nga detyra të një subjekti rivlerësimi, duke arritur në përfundimin se ky i fundit nuk kishte deklaruar burimin e pasurisë për blerjen e një apartamenti në Korçë. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar pasurinë shtëpi me sipërfaqe ndërtimi të konsiderueshme në fshatin Maliq Korçë, që figuronte e legalizuar. Për të gjitha gjetjet me lart, KPA ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke lënë në fuqi vendimin e KPK me arsyetimin se ky subjekt nuk ka deklaruar burim të krijimit të pasurive dhe ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me mënyrën e përfitimit të disa prej tyre. Megjithëse subjekti i rivlerësimit është shkarkuar, deri me sot nuk ekziston asnjë referim për ndjekje penale apo çështje gjyqësore në ngarkim të tij nga ana e organeve të drejtësisë për akuzat e mësipërme.

Në Vendimin e korrikut 2020, trupi gjykues i KPA, pasi analizoi çështjen në tërësi, shkaqet e ankimit dhe provat e administruara në këtë çështje, arriti në përfundimet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë për pasurinë apartament banimi dhe garazh ndodhur në Tiranë. Po ashtu, sipas KPA, ky subjekt ka bërë deklaram të rremë lidhur me burimin e krijimit të një tjetër

⁴⁶ Neni 257/a i ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (I ndryshuar);

pasurie të paluajtshme në Tiranë, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar një automjet luksoz në pronësi të tij.

KPA konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në letra me vlerë në obligacione thesari, si dhe ka fshehur detyrimin financiar për shkollimin e personit të lidhur me të, si dhe nuk ka burime të ligjshme për të mbuluar këtë shpenzim, deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë vetting. Për analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, KPA mbështet gjetjet e KPK duke lënë në fuqi vendimin e saj për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit për fshehje dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera. Kjo çështje nuk është ndjekur ende nga ana e organit të akuzës qoftë kryesisht apo me kallëzimin penal të ndonjë institucioni apo individi.

Në Vendimin e korrikut 2020, trupi gjykues i KPA pasi shqyrtoi të gjitha provat e aktet e administruara nga KPK gjatë hetimit administrativ për këtë çështje, arriti në përfundimin se vendimi i shkarkimit të KPK ishte i drejtë e i bazuar dhe për këtë arsye ai vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Në konkluzionet që parashtroi KPA për shkarkim, lidhur me çështjet pasurore, konstatohej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë për pasurinë tokë arë në Shkodër dhe kishte kryer deklaram të rremë për pasurinë shtëpi banimi në Milot. KPA konkludoi se ky subjekt kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e këtyre pasurive. Në vijim të këtij shkarkimi nga detyra, rezulton se mbi këtë çështje nuk është referuar apo nisur kryesisht ndjekje penale deri më sot.

Në Vendimin e nëntorit 2020, trupi gjykues i KPA, pasi analizoi të gjitha gjetjet e përcjella nga KPK dhe në legjislacionin e zbatueshëm, arriti në përfundimet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultuan se kishin fshehje të të ardhurave reale dhe mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar shpenzimet dhe pasuritë për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012. Po ashtu, KPA argumentoi se në lidhje me pasurinë apartament banimi në Tiranë, është kryer fshehje pasurie. Madje fshehje të pasurisë të luajtshme ka pasur edhe në lidhje me një deklaratë noteriale të një shtetasi për një shumë të konsiderueshme që ia ka dhënë subjektit të rivlerësimit pa kundërshpërblim dhe pa kthim. Për të gjitha sa me lart, KPA vendosi të lërë në fuqi vendimin e KPK për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Kjo çështje nuk është ndjekur më tej për hetim dhe gjykim nga organet e drejtësisë, duke e lënë subjektin të lirë dhe jashtë përgjegjësisë ligjore.

Në Vendimin e dhjetorit 2020, KPA në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen e përcjellë nga KPK që kishte vendosur shkarkim për subjektin e rivlerësimit, arriti në përfundimet se ky subjekt për pasurinë apartament banimi në Kukës, kishte mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë. Po ashtu, lidhur me analizën financiare të viteve 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015, KPA konkludoi se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e kryera në këto vite, duke dhënë deklarime fiktive. Si rrjedhojë, KPA vendosi lënien në fuqi të vendimit të KPK për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, por deri më sot nuk ka ende një hetim penal mbi të dhënat pasurore dhe informacionet fiktive që ai ka deklaruar në pasqyrat e dorëzuara pranë organeve të vettingut.

Në Vendimin e janarit 2021, KPA në përfundim të shqyrtimit të çështjes ndaj subjektit të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, konstatoi se për pasurinë apartament në Tiranë, subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe ka kryer fshehje të të dhënave të deklarimit për të mbuluar situatën reale. Në lidhje me pasurinë e luajtshme automjet, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, ndërsa në lidhje me pasurinë likuiditete në formën e gjendjes *cash* dhe likuiditete në bankë përgjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar gjendjet e deklaruara, duke rezultuar me mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë. Në lidhje me gjetjet e mësipërme, KPA vendosi shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, por ende dosja e tij nuk është marrë për hetime të mëtejshme nga organi akuzës.

Në Vendimin e janarit 2021, trupi gjykues i KPA, pasi analizoi gjetjet në vendimin e KPK për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, konstatoi se pasuria apartament banimi e këtij subjekti ndodhur në Tiranë, ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në vlera të konsiderueshme në valutë të huaj. Ndërsa për pasurinë automjet, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të dhëna të rreme, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri. Ndërkohë që, KPA deklaroi se për analizën financiare për vitet 2007, 2010, 2011, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të tjera të theksuara të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe për shpenzimet e kryera. Për sa me lart, KPA ka lënë në fuqi vendimin e KPK për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, por ky i fundit nuk është përballur ende me hetime penale, ku të sqarohen rrethanat korrekte të mënyrës sesi janë përfutur pasuritë e tij.

Në Vendimin e marsit 2021, KPA pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga ana e KPK, arriti në konkluzionin se ky subjekt nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat për blerjet e pasurive të tij. Madje në disa raste ai është munduar të fshehtë dhe të servirë të dhëna të rreme për të mbuluar të vërtetën e burimeve të financimit. Konkretisht, në lidhje me pasurinë e paluajtshme apartament dhe garazh të ndodhura në Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të dhëna të pasakta, ndërsa për pasurinë e luajtshme automjet ky subjekt rezultoi me fshehje dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë. KPA konstatoi gjithashtu se në lidhje me analizën financiare të të ardhurave të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për vitet 2006 – 2014, si dhe likuiditetet në formë *cash* të deklaruara, jashtë sistemit bankar, në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme. Megjithatë, vendimi KPA ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit për arsyet e mësipërme, kjo çështje nuk është hetuar ende nga ana e organit të prokurorisë, duke mos e përballur këtë subjekt me përgjegjësitë ligjore përkatëse.

Në Vendimin e korrikut 2021, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i KPA konstatoi se vendimi i KPK për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit ka qenë i drejtë dhe i bazuar duke e lënë atë në fuqi. Ky përfundim vinte nga fakti se subjekti kishte kryer deklarim të pasaktë të pasurive në deklaratën e pasurisë vetting, pasi nuk ka deklaruar burimet e krijimit të pasurive në pronësi të tij dhe të personave të lidhur me të. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, kanë kryer deklarim të rremë të të ardhurave të krijuara, përkatësisht nga

ushtrimi i profesioneve private. Për pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” në Tiranë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së kësaj pasurie. Kjo pamjaftueshmëri konstatohet në diferencë të madhe edhe për pasurinë e paluajtshme të llojit “dyqan”, blerë në vlera të konsiderueshme të valutës së huaj, si dhe të pasurisë së paluajtshme të llojit truall në Shkodër. Për këtë çështje nuk ka ende një hetim penal mbi të dhënat pasurore nga ana e organit të akuzës.

Në Vendimin e tetorit 2021, KPA pasi mori në shqyrtim ankimin e subjektit të rivlerësimit dhe përmbajtjen e vendimit të shkarkimit të tij nga ana e KPK, konkludoi se shkarkimi bazohet në ligj dhe prova. KPA arriti në këtë konkluzion për shkak se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa pagesa të padeklaruara për blerjen me kredi të një apartamenti në Tiranë dhe për më tepër ai ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar atë dhe shpenzimet e tjera familjare. Nga analiza financiare e kryer për vitet 2010 - 2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të përballuar pasuritë e vëna, shpenzimet e kryera dhe pagesën e detyrimeve për vlera të konsiderueshme në lek dhe valutë të huaj. Megjithatë ky subjekt rezultoi i shkarkuar nga KPA për konstatimet e mësipërme, nuk ka ende një hetim penal mbi të dhënat problematike të gjetura në hetimin e tij të thelluar pasuror.

Në Vendimin e marsit 2022, trupi gjyqësor i KPA, në përfundim të shqyrtimit të çështjes së shkarkimit nga detyra të një subjekti rivlerësimi nga ana e KPK, pasi analizoi të gjitha provat dhe faktet, si dhe bazuar në aktet e administruara, doli në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shlyerjen e një kredie për blerjen e një apartamenti në Tiranë. Po ashtu, nga analiza financiare për vitet 2005, 2007, 2009, 2011, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar pasuritë e përbëra nga dy apartamente dhe një automjet. KPA vlerësoi se mungesa e justifikuar e një seri asetesh të paluajtshme ishte përcjellë me një mori deklarimesh fiktive në vitet respektive. Për këtë arsye, KPA vendosi shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, por çështja duhet të përcillet për hetime të mëtejshme në organin e akuzës.

Në Vendimin e marsit 2022, KPA arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendej në pamundësi për të justifikuar me burime të ligjshme të ardhurat e përdorura për të përballuar shpenzimet për jetesë, blerjen e apartamentit, si dhe ndërtimin e banesës në periudhat kohore të pretenduara prej tij. Për pasojë, deklaratat e dhëna kanë qenë me probleme në të dhënat e pasqyruara, të cilat nuk janë reale sipas situatës faktike të provuara nga hetimet e thelluara vetting. Këto deklaratime kanë qenë për pasuri apartament, shtëpi private dhe truall. Për sa me lart, KPA vendosi shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, por ajo që nevojitet më tej është referimi për hetime me të specializuara penale nga ana e organit të akuzës.

Në Vendimin e prillit 2022, KPA konkludoi se subjekti i rivlerësimit kishte probleme të konstatuara me mosdeklarimin e të ardhurave nga qiraja e objektit në pronësi të tij, çfarë nuk ishte pasqyruar në deklaratat e tij të pasurisë. Po ashtu, KPA konstatoi se nga kontrolli i kryer mbi saktësinë e deklaratimit dhe verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie si dhe të një automjeti, rezultoi se ato nuk janë bindëse dhe të plota, por ka mosdeklarim

dhe fiktivitet. Për këtë arsye, KPA vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit, dhe ajo që mbetet aktualisht si veprim është referimi i këtyre gjetjeve për hetime të mëtejshme penale.

Në Vendimin e majit 2022, KPA pas analizimit të akteve, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer mosdeklarim të mënyrës sesi janë shpenzuar shumat e konsiderueshme të parave të marra nga kreditë në bankë, pasi ka pasur detyrimin për ta bërë këtë në çdo vit kalendarik deklarinim pasuror. KPA konstatoi gjithashtu, se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues në lidhje me krijimin e kursimeve *cash* në shuma të konsiderueshme dhe nuk i ka deklaruar ato në asnjë prej deklaratave periodike. Po ashtu, nuk është deklaruar një hua e dhënë në një shumë tjetër të konsiderueshme valutë ndaj një të afërmi, çfarë ngre dyshime të forta për fshehje të pasurisë të krijuar nga burime të paligjshme dhe të padeklaruara. Për këto arsye, KPA ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, por nevojiten hetime të mëtejshme penale, të cilat duhet të zbardhin në mënyrë të plotë elementet e veprave penale të konsumuara në rastin konkret.

Në Vendimin e majit 2022, KPA në përfundim të shqyrtimit të çështjes konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka parregullsi të dukshme në deklarinimet për një apartament dhe pamjaftueshmëri për ta blerë atë me një kredi bankare të deklaruar. Po ashtu, konstatoi mungesë burimesh financiare të ligjshme në shuma të konsiderueshme për të përballuar shpenzimet familjare dhe blerjen e një automjeti. Për pasurinë, një tjetër apartament rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim fiktiv në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, lidhur me vlerën e deklaruar të blerjes së kësaj pasurie. Në përfundim, KPA duke evidentuar faktin se në analizën financiare për periudhën 2004-2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare dhe problematika në deklarinimet e tij pasurore, vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit. Për ndjekjen e mëtejshme të kësaj çështje nga ana e organit të akuzës, nevojitet një referim konkret me qëllim që të qartësohet ligjërisht burimi i vërtetë i të ardhurave në raport me deklarinimet e parregullta të dokumentuara.

REKOMANDIME

Në përfundim të analizës së mësipërme dhe evidentimit të problematikave dhe shkeljeve të konstatuara, me të cilat përballet procesi i *vettingut*, duke kultivuar ende kulturë pandëshkueshmërie ndaj shumë subjekteve të rivlerësimit kalimtar të shkarkuar, si dhe me qëllimin për të përmirësuar këtë situatë dhe për ta sjellë në standardet e kërkuar nga ligji dhe pritshmëritë e larta publike, propozohen rekomandimet e mëposhtme:

- Unifikimin e metodologjisë së raportimit vjetor mbi veprimtarinë e organit të Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm për evidentimin e çështjeve të hetuara për subjektet e rivlerësimit kalimtar të shkarkuar nga procesi i vettingut;*
- Unifikimin e metodologjisë së raportimit vjetor mbi veprimtarinë e gjykatave të posaçme për evidentimin e çështjeve të gjykuara për subjektet e rivlerësimit kalimtar të shkarkuar nga procesi i vettingut;*
- Ndryshimin e metodologjisë së raportimit të vjetarit statistikor të Ministrisë së Drejtësisë, duke krijuar rubrikë të veçantë për çështjet e hetuara dhe gjykuara për subjektet e rivlerësimit kalimtar të shkarkuar nga procesi i vettingut;*
- Evidentimin e rasteve nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat megjithëse janë publikuar me elemente të dukshëm të veprave penale të kryera nga ana e subjekteve të rivlerësimit, nuk figurojnë të jenë në hetim apo gjykime penale, duke evidentuar shkelje të mundshme nga ana e organit të prokurorisë;*
- Unifikimin e praktikës së detyrimit për kallëzime penale të bashkërenduara për shkeljet e konstatuara gjatë procesit të vettingut nga ana e KPK, KPA dhe Institucionit të Komisionerëve Publik;*
- Unifikimin e praktikës, elementeve dhe rasteve se kur investohet fillimi i ndjekjes penale kryesisht nga ana e Prokurorisë së Posaçme apo prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për vendimet e rivlerësimit kalimtar me shkarkim, kur konstatohen dyshime të arsyeshme për konsumim të veprave penale nga ana e subjekteve të hetuar;*
- Miratimin e një metodologjie të re për investigimin e rasteve të hetimit pasuror për subjektet e rivlerësimit të shkarkuar nga vettingu, duke përfshirë elementë të rinj për hetime të thelluara penale mbi shkaqet e pamjaftueshmërisë së burimeve të paligjshme të pasurimit të tyre, të cilat mund të plotësojnë më mirë në punën e tyre organet ligjzbatuese në hetimin e çështjeve të korrupsionit dhe pastrimit të produkteve të veprës penale;*
- Rritjen e rolit të organeve të tjera bashkëpunëtore në hetimin e thelluar administrativ të subjekteve të rivlerësimit (ILDKPKI, Hetimi Tatimor, Drejtoria e Pastrimit të Parave, etj), duke gjeneruar më shumë vetiniciativë gjatë konstatimeve flagrante në shkelje të ligjit penal për të kryer kryesisht kallëzime penale të veçanta në raste konkrete;*

9. *Evidentimin në raportet vjetore të veprimtarisë së KPK, KPA dhe Institucionit të Komisionerëve Publike të të gjitha çështjeve, për të cilat ka vendim të formës së prerë për shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke dhënë shpjegime për mënyrën e trajtimit të tyre të mëtejshëm, kur ka konstatime për shkelje të ligjit penal;*
10. *Realizimin e një procedure të përsheptuar për të referuar apo nisur kryesisht ndjekjen penale për vendime të viteve të mëparshme të formës së prerë të KPK ose KPA për shkarkim nga detyra për motive kryesisht pasurore të subjekteve të rivlerësimit, me qëllim shmangien e rasteve që rrezikojnë të parashkruhen;*

Botues:

Qendra ALTRI

Rr. "Asim Zeneli", Nr. 15, Tiranë

E-mail: qendra.altri@gmail.com

Mob: +355 69 205 0676

Web: <http://www.altri.al/>

Ky publikim është mbështetur nga:

Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

Foundation Office Albania

Blv. "Dëshmorët e Kombit", Twin Tower 1, 11th Floor, Office A3

Tirana, Albania

www.kas.de